



AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

KARTA E BARDHË E KUVENDIT

(Rezoluta)

"VAZHDIMËSIA HISTORIKO-GJUHËSORE DHE ETNOKULTURORE E SHQIPTARËVE PËRMES MIJËVJEÇARËVE,"

Shoqatat organizatore:

"ILIRICUM SACRUM"

FORUMI "IMAZH & MEDIA"

UNIONI SHQIPTAR I SHOQËRISË CIVILE

ORGANIZATA ALVA-ALBANIAN VALUES-VLERAT SHQIPTARE

"ALENCA QYTETARE PËR MBROJTJEN E VLERAVE KOMBËTARE"

SHOQATA "PAL ENGJËLLI"

FORUMI I MBROJTJES SË TRASHËGIMISË HISTORIKE KULTURORE KOMBËTARE

"NIKAJ MËRTUR"

SHOQATA MBARË KOMBËTARE "BYTYÇI"

LIDHJA E HISTORIANËVE TË KOSOVËS "ALIHADRI"

SHOQATA "MENV GROUP"

QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE- G & G GROUP

Në marrëveshje me:

Universitetin e Tiranës Universitetin "Aleksadër Xhuvani",

Elbasan Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë Universitetin

European të Tiranës, Tiranë

Tiranë, 09-12 Maj, 2019, MUZEU KOMBËTAR



AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

KARTA E BARDHË E KUVENDIT

Kuvendi i parë ndërkombëtar mbi vazhdimësinë historiko-gjuhësore dhe etnokulturore të shqiptarëve përmes mijëvjeçarëve, me qëllim rritjen e vetëdijes së shqiptarëve mbi rëndësinë e njohjes së lidhjeve të historisë së tyre me kulturat e antikitetit pati një prurje me mbi 90 referate dhe kumtesa të mbajtura nga shkencëtarë, profesorë dhe ekspertë të historisë e gjuhësisë nga çdo trevë e Shqipërisë. Duke u bazuar tek i gjithë materiali prezantues, ku përfshihen fusha të ndryshme studimesh, jemi plotësisht të vetëdijshëm që Shqipëria zotëron sot potencialin e saj me studiues, të aftë të kryejnë kërkime dhe studime të thella shkencore, të analizojnë me objektivitet faktet e fushave të ndryshme. Dhe mbi bazën e analizës krahasuese të arrijnë në përfundime objektive e të mbështetura mbi prova të faktuara, me qëllimin për të hedhur dritë mbi ato të vërteta – deri tani të lëna në mjegull e harresë - për t'ua drejtuar shkrimin e historisë mbi bazën e të cilave të ngrihet e vërteta mbi të. Të vetëdijshëm tashmë në kërkim të rrënjëve të etnogjenezës sonë, si e drejta jonë natyrore e dhënë nga zoti si popull dhe si komb, ne, intelektualët dhe akademikët shqiptarë, përfaqësues dhe mbrojtës me baza shkencore të idesë së vazhdimësisë dhe lidhjes së pandërprerë historiko-gjuhësore dhe etnike të popullit e kombit tonë që nga para antikiteti deri në ditët e sotme, u parashtrijmë aktorëve politikbërës, faktorëve vendimmarrës, qëndror e lokal rezolutën në vijim, ku kemi parashtruar idetë thelbësore - si mekanizma me përmasa ndikuese të jashtëzakonshme në zhvillimin, ecurinë dhe rritjen e potencialit krijues e ekonomik të një vendi:





AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

I. KRIJIMI I INSTITUTIT TË STUDIMEVE TË GJUHËS PROTOSHQIPE ME QËLLIM

1. Kërkimin, mbledhjen dhe studimin e materialit gjuhësor të trashëguar nga gjuha thrako-ilire dhe pellazgo-epire.
2. Kërkimin, mbledhjen dhe studimin e materialit gjuhësor të trashëguar nga gjuhët e para antikitetit si sumerishtja, etruskishtja, etj.
3. Përgatitjen e akademikëve, studiuesve dhe ekspertëve shqiptarë në fushën e ilirishtes dhe në atë të pellazgjishtes dhe të krijohet edhe një degë e etruskologjisë.
4. Studimi i emërtimeve gjeografike.
5. Krijimi brenda këtij Instituti i degëve për studimin e gjuhëve të tjera të vjetra të antikitetit të hershëm, si studimi i pllakave Sumere, si dhe i gjuhëve të tjera.
6. Krijimi i Bibliotekës me studimet e gjuhëtarëve dhe historianëve të huaj të kohëve të sotme mbi Ilirishten dhe Pellazgjishten dhe përkthimi i këtyre studimeve në gjuhën shqipe.
7. Hartimi i një programi për mundësimin e kërkimeve dhe studimeve, si dhe të botimeve të veprave me vlerë në këtë fushë - propagandimin dhe shpërndarjen e tyre.





II. NJOHJA ZYRTARE E GJUHËS SË SHKRUAR E PARAKE TË SHQIPES

1. Akademia e Shkencave të ketë expertët, të cilët duhet të kujdesen për trashëgiminë e gjuhës ilire dhe të gjuhëve të antikitetit.
2. Krijimi i katedrës së ilirishtes tek Fakulteti i Gjuhë-Letërsisë.
3. Të punohet për njohjen zyrtare mbi baza shkencore lidhja dhe prejardhja pellazgo-ilire e shqiptarëve.
4. Futja e ilirishtes si lëndë e veçantë tek shkencat shoqërore, veçanërisht tek degët gjuhë/letërsi, gazetari dhe histori me qëllim përgatitjen e kuadrit akademik shqiptarë me njohuritë e duhura në këtë fushë, për t'i përcjellë ato te brezi i ri.





AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

III. FUTJA NË PROGRAMET E SHKOLLAVE DHE NË INSTITUCIONET E VENDIT

1. Mësimin e gjuhës shqipe si lëndë kyçe, sipas përvojës më të mirë evropiane dhe botërore, si dhe përpunimi i programit për transemtimin e njohurive mbi trashëgiminë nga gjuha e shkruar ilire dhe njohuritë mbi gjuhën pellazge.
2. Të kërkohet me këmbëngulje rritja e vetëdijes për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe të kryhet rishikim i programeve mësimore dhe i librave të historisë.
3. Të kihet një studim i veçantë të veprave ILIRICUM SACRUM, ku të trajtohet në detaje pjesa që shkruan për luftën e Trojës.
4. Të realizohet botimi i një vepre shkencore historike, ku të jenë pasqyruar monumente të historisë tonë kombëtare.
5. Përdormi i fjalorit të pastër shqip në gjuhën e mediave dhe zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë shqipe.
6. Lëvrimi dhe përdorimi i gegënishtes, format gjuhësorë dhe fjalët e këtij dialekti dhe të punohet e lobohet që gegënishtja të konsiderohet nga UNESCO, si vlerë botërore e të ruhet.
7. Të kërkohet lektorimi dhe redaktimi i çdo lloj botimi në të gjitha llojet e mediave, veçanërisht në gazetari dhe dokumentacionin zyrtar, ku institucionet zyrtare të kenë redaktues dhe lektorë të kualifikuar.





AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

9. Të kërkohet nga Institutionet shtetërore përcaktimi i një fondi për botimin e fjalorëve të unifikuar dhe shpërndarjen e tyre me çmime të përshtashme për masën e gjerë.
10. Mbajtja e seminareve dhe leksioneve mbi gjuhën shqipe, gramatikën, stilistikën, leksikun, institucionalizimi i këtyre veprimtarive për mbrojtjen dhe ruatjen e pasurisë e gjuhës dhe mediat të pasqyrojnë dhe propagandojnë me intesitet aktivitetet në fushën e gjuhësisë



IV. NË FUSHËN E ETNOKULTURËS

1. Thesari i paçmuar i trashëgimisë kombëtare shqiptare që gjendet në Fondin Shtetëror, (mbi 30,000 objekte etnografike); Trashëgimia kulturore në muzeumet shtetërore brenda e jashtë kufijve dhe ato në pronësi të personave privat në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi e Maqedoni; Koleksionet e krijuara, veçanërisht, në dy dekadat e fundit, si ato të Gjon Dukgilaj, Shtjefën Ivezaj, Nebi Dervishi, Kaim Murtiqi, Bujar Gazheli, Lulzim Perati, Loreta Mokini, Teodor Dhoska, Linda Spahiu, Vasilika Sherifaj dhe shumë familjeve malësore; Fondi enciklopedik prej qindra-mijëra negativësh në Fototekën Marubi, etj., të kthehen në destinacione turistike dhe të bëhet rivlerësimi i kësaj kulture.
2. Të krijohet shkolla e trashëgimisë kulturore, ku:
 - a) të ringjallet historia e Thesprotisë – nëpërmjet traditave, gojëdhënave dhe zakoneve çame.
 - b) të bëhet gjendja e ikonave në Republikën e Shqipërisë, ku në v.1990, fondi i tyre arrinte deri në 1200 copë të tilla.
 - c) të bëhet ndalimi i shitjes së objekteve, me vlerë kulturore-historike, qoftë edhe ato që ndodhen në pronësi private dhe të kemi ashpërsim të ligjeve për pasuritë arkeologjike dhe natyrore.
 - d) të vlerësohen mjeshtrat e artizanatit dhe të bëhet ekspozimi dinjitoz i objekteve të shumta arkeologjike që janë të hedhura pa kujdes nëpër magazina.
 - e) nëse Polifonia Labe u fut nën mbrojtjen e UNESCO-s, si pjesë e çmuar e kulturës botërore, edhe Xhubleta e Zezë 4000 vjeçare, si veshja më e vjetër e botës, të vendoset nën mbrojtjen e shtetit shqiptar dhe të autoritetit institucional perëndimor.



AKADEMIA ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

3. Të rishikohen përgatitjet dhe njohuritë e ciceronëve dhe shoqëruesve të grupeve turistike në qendrat antike brenda vendit.
4. Të bëhet e mundur realizimi i nje muzeu dinjitoz për Nënë TEREZËN dhe të lobohet për një film hollivudian për SKENDERBEUN, për një film hollivudian per ADEM JASHARIN, si dhe të lobohet për një film hollivudian për CAMËRINË.
5. Të kryhet përkthimi dhe botimi në shqip i albanologëve botërore (të papërkthyer), sidomos i arbëreshëve.
6. Forcimi i lidhjeve të gjithanshme me diasporën (sidomos me arbëreshët, arvanitët, sardët, etj.).
7. Të realizohet kryerja e riteve fetare në gjuhën shqipe dhe të lobohet per autoqefaline e kishës ortodokse të Kosovës.



PËR AKADEMINË ALTERNATIVE SHKENCORE "RRËNJËT TONA"

PRESIDENT I KUVENDIT
Dr. Stefan **PINGULI**

DREJTOR ORGANIZATIV
Prof.ing. Av. Sazan **GURI**

KRYETAR I KOMITETIT SHKENCOR
Fatbardha **DEMI**

KRYETAR I KOMITETIT ORGANIZATIV
Ing.dipl. Fred **BALAJ**